



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

Numër | 2
Shkurt | 2015

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike

Numër 2

BOTUES	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës © Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike 33 Garibaldi, Prishtinë 10000 Tel: ++381 38 222 243 Fax: ++381 38 243 763
FAQJA E INTERNETIT	www.bqk-kos.org
ADRESA ELEKTRONIKE	economic.analysis@bqk-kos.org ;
KRYEREDAKTOR	Arben MUSTAFA
REDAKTOR	Sokol HAVOLLI
AUTORË	Zana GJOCAJ Bejtush KIÇMARI
REDAKTOR TEKNIK	Butrint BOJAJ
SHTOJCA STATISTIKORE:	Departamenti i Statistikave

VËREJTJE:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2014),
Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike Nr. 2, Prishtinë.
Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

SHKURTESAT

ALL	Leku Shqiptar (<i>angl: Albanian Lek</i>)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore (<i>angl: Central European Free Trade Agreement</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl: Swiss Frank</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (<i>angl: Consumer Price Index</i>)
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian mbi Sundimin e Ligjit (<i>angl: European Union Rule of Law Mission</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFO	Instituti për Hulumtime Ekonomike
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë (<i>angl: NATO-led Kosovo Force</i>)
MKD	Denari Maqedon (<i>angl: Macedonian Denar</i>)
NPL	Kreditë jo Përformuese (<i>angl: Non-performing Loans</i>)
OPEC	Organizata e Vendeve për Eksportin e Naftës (<i>angl: Organization of Petroleum Exporting Countries</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (<i>angl: Producer Price Index</i>)
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (<i>angl: Real Effective Exchange Rate</i>)

SIMBOLET KONVENCIONALE

"—"	dukuria nuk ekziston
". "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
"..."	zero ose afër zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	preliminare
(r)	e reviduar

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje Ekzekutive	11
2. Ekonomia e Eurozonës	13
3. Ballkani Perëndimor	16
4. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare	18
4.1. Çmimet e arit	19
4.2. Çmimet e metaleve dhe mineraleve	19
4.3. Çmimet e prodhimeve ushqimore	20
5. Ekonomia e Kosovës	21
5.1. Çmimet	21
5.1.1 Struktura e inflacionit dhe inflacioni bazë	21
5.1.2 Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe të pa tregtueshme	23
5.1.3 Çmimet e importit, çmimet e prodhimit dhe norma reale efektive e këmbimit	24
5.2. Produkti i brendshëm bruto	25
5.3. Zhvillimet Sektoriale	26
5.3.1 Sektori i Ndërmarrjeve	28
5.4. Sektori i jashtëm	29
5.4.1 Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale	29
5.4.2 Llogaria financiare	35
5.4.3 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve	37
5.4.4 Borxhi i jashtëm	38
5.5. Sektori fiskal	39
5.5.1 Të hyrat buxhetore	40
5.5.2 Shpenzimet buxhetore	41
5.6. Sistemi Financiar	42
6. Parashikimet makroekonomike për vitin 2015	45
6.1. Produkti i brendshëm bruto	45
6.2. Sektori fiskal	46
6.3. Sektori bankar	47
6.4. Sektori i jashtëm	47
7. Shtojca statistikore	49
8. Referencat	69

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rritja reale e PBB-së-----	13
Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike -----	14
Figura 3. Inflacioni vjetor-----	14
Figura 4. Papunësia -----	14
Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së -----	15
Figura 6. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJK-----	16
Figura 7. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJK -----	17
Figura 8. Norma e kredive jo performuese në EJK -----	18
Figura 9. Çmimi i naftës “brent crude”-----	18
Figura 10. Çmimet i arit -----	19
Figura 11. Indeksi i çmimeve të metaleve -----	19
Figura 12. Indeksi i çmimeve të ushqimit -----	20
Figura 13. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij -----	21
Figura 14. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan -----	21
Figura 15. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tij -----	21
Figura 16. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë -----	22
Figura 17. Indeksi i çmimeve të energjisë dhe çmimi për KWh -----	22
Figura 18. Çmimet e shërbimeve -----	22
Figura 19. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	23
Figura 20. Pjesëmarrja e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në komponentët e IÇK-së -----	23
Figura 21. IÇK gjithsej dhe komponentët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm -----	24
Figura 22. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	24
Figura 23. Rritja reale e PBB-së -----	25
Figura 24. Komponentat kryesore të PBB-së-----	25
Figura 25. Prodhimi, konsumi dhe bilanci i energjisë -----	26
Figura 26. Konsumi i energjisë sipas përdoruesit të fundit -----	26
Figura 27. Transporti hekurudhor në Kosovë-----	27
Figura 28. Transporti ajrorë në Kosovë -----	27
Figura 29. Indeksi i prodhimit industrial -----	28
Figura 30. Regjistri i bizneseve -----	28
Figura 31. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	28
Figura 32. Bilanci i llogarisë rrjedhëse -----	29
Figura 33. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar-----	30
Figura 34. Gjithsej eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve-----	31

Figura 35. Gjithsej importet dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit -----	31
Figura 36. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve -----	32
Figura 37. Struktura e neto eksportit të shërbimeve -----	33
Figura 38. Të ardhurat parësore -----	34
Figura 39. Të ardhurat dytësore -----	34
Figura 40. Pranimet e remitencave -----	35
Figura 41. Investimet e huaja direkte -----	36
Figura 42. Kreditë tregtare dhe importet -----	37
Figura 43. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve -----	37
Figura 44. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional -----	38
Figura 45. Borxhi i jashtëm bruto -----	38
Figura 46. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve -----	39
Figura 47. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore -----	39
Figura 48. Treguesit kryesor fiskal të EJL-së -----	40
Figura 49. Struktura e të hyrave buxhetore -----	40
Figura 50. Të hyrat vendore neto sipas llojeve të tatimeve -----	40
Figura 51. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve -----	41
Figura 52. Struktura e shpenzimeve buxhetore -----	41
Figura 53. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	42
Figura 54. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	42
Figura 55. Mesatarja vjetore e normave të interesit -----	43
Figura 56. Treguesit e profitabilitetit -----	43
Figura 57. NPL-të dhe provizionet -----	44
Figura 58. Rritja reale e PBB-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme -----	45
Figura 59. Rritja reale e PBB-së dhe kontribuuesit në rritje -----	45
Figura 60. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore -----	46
Figura 61. Kreditimi ndaj sektorit privat dhe PBB-ja reale -----	47
Figura 62. Depozitat e sektorit privat dhe PBB-ja reale -----	47
Figura 63. Llogaria rrjedhëse -----	47
Figura 64. Eksporti dhe importi i mallrave -----	48

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor -----	16
Tabela 2. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor -----	17
Tabela 3. Ndarja e IÇK-së -----	23
Tabela 4. Llogaria financiare -----	36

1. Përmbledhje Ekzekutive

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u rikuperua me një ritëm më të ngadalshëm, përderisa rritja ekonomike mbeti e pabarabartë dhe me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Eurozona shënoi normë pozitive të rritjes ekonomike, megjithëse vetëm tremujori i parë i vitit u karakterizua me rikuperim më të fuqishëm të rritjes ekonomike përderisa në dy tremujorët vijues rimëkëmbja u ngadalësua. Përkundër uljes së vazhdueshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane, eurozona u karakterizua me kërkesë më të ulët dhe rënie të normës së inflacionit gjatë vitit 2014, duke ngritur kështu shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje më të dobët ekonomike krahasuar me vitin paraprak. Performanca e dobësuar e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 ka ndikuar që vlerësimi për rritjen ekonomike të jetë vetëm 1.8 përqind (2.5 përqind në vitin 2013). Shkalla e ulët e inflacionit në nivel global si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe kërkesa përgjithësisht më e ulët në rajon ka rezultuar në norma më të ulëta të inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Karakteristikë e përbashkët e vendeve të Ballkanit Perëndimor mbetet deficit i llogarisë rrjedhëse, që gjatë vitit 2014 shënoi rritje të mëtejme. Sektori fiskal në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me përmirësim të bilancit buxhetor, ndërkohë që borxhi publik ka vazhduar të mbetet i lartë. Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me zhvillime të ndryshme, ku kreditimi në disa prej vendeve shënoi rritje e në disa të tjera u zvogëluar. Sa i përket depozitave, trendi i rritjes së tyre është përsheptuar në shumicën e vendeve të rajonit.

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së ishte 3.0 përqind, që përkon me një ndër normat më të larta të rritjes ekonomike në rajon. Kjo rritje u përcaktua nga ecuria pozitive e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Rritja e konsumit gjatë vitit 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, si dhe rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë. Investimeve në vitin 2014 u karakterizuan me rënie të konsiderueshme, kryesisht për shkak të rënies së investimeve publike. Në të njëjtën periudhë, thellimi i deficitit tregtar të mallrave ka ndikuar që neto eksportet gjatë vitit 2014 të kontribuojnë negativisht në rritjen e PBB-së. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave gjatë vitit 2014, niveli shumë më i lartë i importit ka bërë që neto eksportet të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike.

Zhvillimet sektoriale gjatë vitit 2014 tregojnë për një rënie të prodhimit të energjisë krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, niveli i humbjeve në rrjet në sektorin e energjisë vazhdon të mbetet relativisht i lartë, megjithëse që nga viti 2009 humbjet në rrjet kanë shënuar rënie të vazhdueshme. Me rënie është karakterizuar edhe konsumi i energjisë gjatë vitit 2014, që mund ti atribuohet kushteve më të favorshme klimatike në muajt e parë të vitit 2014. Të dhënat e indeksit për prodhimin industrial tregojnë për rritje të vazhdueshme të prodhimit në industrinë nxjerrëse dhe sjellje relativisht stabile të industrisë përpunuese gjatë vitit 2014. Sa i përket sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, ngrohjes dhe gazit, trendet kanë qenë mjaftë pozitive.

Përkundër rritjes së konsumit, inflacioni është karakterizuar me rënie gjatë gjysmës së parë e sidomos në tremujorin e fundit të vitit 2014. Kjo rënie e shkallës së inflacionit është kryesisht rezultat i zvogëlimit të çmimeve të mallrave të importuara, gjë që reflekton lidhshmërinë e fortë të zhvillimeve në nivelin e çmimeve në Kosovë me ato në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2014 ishte 0.4 përqind, që paraqet nivelin më të ulët të

inflacionit në vitet e fundit. Aktiviteti tregtar u karakterizua me rritje si të eksporteve ashtu edhe të importeve. Megjithatë, përkundër normës më të lartë të rritjes së eksporteve krahasuar me importet, ka mbizotëruar pesha më e lartë e importeve duke bërë që eksportet neto të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike. Gjatë kësaj periudhe, investimet e huaja direkte shënuan rënie, ndërkohë që remitencat dëshmuuan se janë burim i qëndrueshëm i financimit duke shënuar rritje të konsiderueshme.

Sektori fiskal u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 22.0 milionë euro deri në qershor 2014 (7.6 milionë euro deficieti në periudhën e njëjtë të vitit 2013). Borxhi i përgjithshëm i qeverisë në periudhën raportuese ishte 554.4 milionë euro apo 9.9 përqind e PBB-së krahasuar me 9.1 përqind sa ishte në vitin 2013. Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të borxhit të përgjithshëm të qeverisë krahasuar me vendet e rajonit (58.1 përqind e PBB-së ishte mesatarja e borxhit publik për vendet e rajonit në vitin 2014). Përveç se ka nivelin më të ulët të borxhit publik, Kosova gjatë vitit 2014 ka shënuar rritje më të ngadalshme të tij krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit.

Sektori financiar ka vazhduar rritjen e qëndrueshme të rolit të tij në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë së vendit. Gjatë vitit 2014, sektori bankar ka lehtësuar standardet dhe kushtet e kreditimit, duke bërë që kreditë të përshpejtojnë ritmin e rritjes dhe të kenë kushte më të favorshme për shfrytëzuesit e tyre. Zgjerimi i vazhdueshëm i kreditimit nga sektori bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda vendit të cilat kanë vazhduar të rriten edhe në vitin 2014. Sektori bankar ka vazhduar të tregojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë, duke vazhduar kështu të ketë rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend.

Për vitin 2015, projeksionet tona sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, e cila pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, sidomos nga investimet. Rritja e kërkesës së brendshme pritet të shkaktojë një ngritje të lehtë të shkallës së inflacionit dhe po ashtu pritet të ndikojë edhe në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, llogaria financiare e bilancit të pagesave pritet të përmirësohet, kryesisht për shkak të parashikimeve për rritje të investimeve të huaja direkte. Sektori fiskal pritet të karakterizohet me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, por rritja e shpenzimeve pritet të jetë më e lartë duke bërë kështu që edhe deficieti primar të rritet në krahasim me vitin paraprak. Për sa i përket sektorit financiar, aktiviteti kredidhënës pritet të përshpejtohet edhe më tutje, duke shërbyer kështu si burim i rëndësishëm i financimit të rritjes ekonomike në vitin 2015.

2. Ekonomia e Eurozonës

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u zhvillua në një ambient më të vështirësuar makroekonomik. Rritja e dobët reale që karakterizoi disa nga rajonet e mëdha në gjysmën e parë të vitit 2014 ndikoi që FMN të revidojë projeksionet për rritjen ekonomike globale dy herë gjatë këtij viti. Parashikimet paraprake të FMN-së sugjerorin rritje ekonomike globale prej 3.6 përqind në vitin 2014, përderisa në korrik dhe përfundimisht në tetor të këtij viti, FMN uli parashikimet e saj në


3.4, përkatësisht 3.3 përqind (figura 1). Pritjet për një aktivitet më të dobët ekonomik edhe në vitin 2015 u pasqyruan në rishikimin e normës së parashikuar paraprakisht prej 4.0 përqind në 3.8 përqind në tetor të vitit 2014. Parashikimet ekonomike ndryshojnë ndërmjet rajoneve dhe sidomos ndërmjet vendeve edhe për vitin 2014. Rritja e aktivitetit ekonomik në nivel global është nxitur kryesisht nga ekonomia e SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, përderisa Japonia dhe eurozona u karakterizuan me rritje modeste ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Ekonomia e eurozonës është karakterizuar me një rritje të dobët reale gjatë vitit 2014. Aktiviteti ekonomik në eurozonë në tremujorin e parë të vitit tregoi shenja më të forta të rimëkëmbjes, përderisa tremujori i dytë dhe tretë i vitit 2014 treguan shenja të dobësimit dhe pothuajse stagnimit të rritjes. Dobësimi i aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2014 si dhe tensionet e ngritura gjeopolitike në mes të Ruisë dhe Ukrainës ndikuan që FMN të revidojë projeksionet ekonomike për vitin aktual dhe vitin 2015. Nga një rritje vjetore paraprakisht e projektuar prej 1.1 përqind në korrik të vitit 2014, në muajin tetor FMN uli pritjet në 0.8 përqind. Edhe për vitin 2015, FMN rishikoi projeksionet ekonomike për eurozonën nga 1.5 përqind sa kishte parashikuar paraprakisht në 1.3 përqind.

Kjo rritje e dobët ekonomike nuk pritet se do të ndikoj në uljen e borxhit publik. Përkundrazi, sipas të dhënave të FMN-së borxhi publik pritet të arrijë në rreth 85 përqind në fund të vitit 2014 nga rreth 83 përqind sa ishte në vitin e kaluar. Pothuajse të gjitha shtete e eurozonës pritët të thellojnë nivelin e borxhit publik, veçanërisht shtetet të cilat cilësohen me nivel të lartë të borxhit publik. Në anën tjetër, Greqia e cila ka nivelin më të lartë të borxhit publik në eurozonë (174.2 përqind e PBB-së), pritët ta reduktoj atë për 1.0 pp. Borxhi publik në eurozonë pritët të thellohet edhe për faktin se pothuajse të gjitha shtet e eurozonës pritët të shënojnë deficit buxhetor i cili në nivel të eurozonës pritët të jetë 2.8 përqind e PBB-së.

Aktiviteti i brishtë dhe i paqëndrueshëm ekonomik u reflektua edhe përmes Treguesit të Sentimentit Ekonomik (TSE) të publikuar nga Komisioni Evropian. TSE përfshinë vërtetimet e besueshmërisë për sektorë të ndryshëm ekonomikë (industri, shërbime, të ndërtimit dhe të tregtisë me pakicë), dhe ekonomitë familjare (të matura përmes besimit të konsumatorëve). Pas një tendence rritëse që nga fundi i vitit 2012, TSE shënoi rënie sidomos nga muaji maj i vitit 2014. Përkeqësimi i TSE-së sidomos në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2014 ishte më i theksuar në Itali, Gjermani dhe Francë.


Figura 1. Rritja reale e PBB-së



Burimi: IMF WEO (Tetor 2014)

Një ndër indikatorët kryesor për vlerësimin e aktivitetit ekonomik në Gjermani, si ekonomia qendrore e eurozonës, është edhe indeksi i biznesit IFO që vlerëson klimën biznesore, gjendjen aktuale të bizneseve dhe pritjet e bizneseve. Sipas këtij indeksi, klima e biznesit në Gjermani në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 mbeti përgjithësisht optimiste. Megjithatë, dobësimi i aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2014 rezultoi në përkeqësim të klimës së biznesit në Gjermani në tremujorin e tretë të këtij viti, përderisa pritjet për gjashtë muajt e ardhshëm mbetën pesimiste (figura 2). Indeksi i klimës së biznesit në Gjermani shënoi rënie për sektorin e prodhimit, të shitjes me shumicë dhe për sektorin e ndërtimit. Ambienti ekonomik në vendet anëtare të unionit mund të pësojë në periudhat në vazhdim nga dobësimi eventual i investimeve dhe eksporteve si pasojë e rreziqeve të ngritura gjeopolitike, rritja e ngathët ekonomike dhe pasiguritë në implementimin e reformave strukturore.


Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike



Burimil: IFO (2014)

Në këtë periudhë, fuqia blerëse e konsumatorëve ka qenë më e lartë, duke iu atribuar nivelit të ulët të inflacionit në eurozonë (figura 3). Presionet e ulëta inflacioniste vazhdojnë të jenë të pranishme në eurozonë, kryesisht si pasojë e kërkesës së dobët, rënies së çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare si dhe problemeve tjera strukturore siç është shkalla ende e lartë e papunësisë. Në vitin 2014, ekonomia e eurozonës pritet të karakterizohet me një normë të inflacionit prej 0.5 përqind (1.3 përqind në vitin 2013).


Figura 3. Inflacioni vjetor



Burimil: IMF, WEO (Tetor 2014)

Reformat e vazhdueshme strukturore në eurozonë janë reflektuar në përmirësim të kushteve në tregjet e punës. Megjithatë, efekti i plotë i reformave të implementuara në tregjet e punës nga disa nga vendet e eurozonës pritet të ndjehet në një periudhë më të vonshme kohore. Norma e papunësisë në vitin 2014 pritet të shënojë një rënie të lehtë në 11.6 përqind, nga 11.9 përqind sa ishte në vitin 2013. Në kuadër të vendeve të eurozonës, tregu i punës në Gjermani rezulton të ketë mbetur i pandryshuar dhe FMN parashikon një normë të ngjashme të papunësisë prej 5.3 përqind në vitin 2014, përderisa Italia, Holanda dhe Finlanda priten të karakterizohen me rritje të lehtë të shkallës së papunësisë.

Figura 4. Papunësia, në përqindje




Burimi: IMF, WEO (Tetor 2014)

Politikat lehtësuese monetare të ndërmarra nga bankat qendrore në vendet e zhvilluara, përfshirë eurozonën, kanë vazhduar ta mbështesin rritjen ekonomike. Aktiviteti i dobët ekonomik ka shkaktuar presion tek BQE për të ndërmarr masa shtesë në politikën tashmë të lehtësuar monetare. Gjatë vitit 2014, BQE intervenoi në norma të interesit në qershor dhe pastaj në shtator, duke i zbritur në nivel rekord, për të nxitur rritjen e kërkesës dhe normalizuar presionet e ulëta inflacioniste. Megjithatë, impulsi i politikës së lehtësuar monetare nuk është përçuar njëtrajtësisht tek ekonomitë periferike të eurozonës dhe nuk është përkthyer në rritje më të fuqishme në ekonomitë qendrore të saj. Mbështetja e sektorit privat përmes kreditimit bankar vazhdoi të mbetet e ulët edhe në vitin 2014 në eurozonë, kryesisht si pasojë e ofertës ende të shtrënguar kredituese, rrezikut kreditor dhe përshtatjeve të vazhdueshme në bilancin e gjendjes së sektorit financiar dhe jofinanciar.

Eurozona është karakterizuar me bilanc pozitiv të llogarisë rrjedhëse prej 0.8 përqind të PBB-së në vitin 2014, (2.4 përqind të PBB-së në vitin 2013). Përmirësimi i llogarisë rrjedhëse në

vendet e eurozonës pritet të nxitet nga rritja më e shpejtë e eksporteve kundrejt rritjes së importeve, përderisa zhvlerësimi i vazhdueshëm i euros kundrejt monedhave të tjera pritet të ndikojë në rritjen e mëtejme të konkurrueshmërisë së mallrave të unionit.

Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së, në përqindje



Burimi: IMF, WEO (Prill 2014)

3. Ballkani Perëndimor¹

Rikuperimi ekonomik që e karakterizoi Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2013 rezultoi në tërësi të mirë në vitin 2014 në këto vende rezultoi të jetë përkeqësuar. Rritja ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 është vlerësuar të jetë 1.8 përqind, që paraqet një rritje më të ulët krahasuar me parashikimin fillestar. Rishikimi i rritjes ekonomike për vendet ballkanike kryesisht i është atribuar rikuperimit të dobët ekonomik në Bashkimin Evropian gjatë vitit 2014 dhe zhvillimeve jo të favorshme në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në kuadër të vendeve të rajonit, ekonomia e Maqedonisë ishte një përjashtim, duke u karakterizuar me përfundim të ritmit të rritjes ekonomike në gjashtëmuorin e parë të këtij viti. Si rrjedhojë, FMN ka parashikuar rritje reale të ekonomisë së Maqedonisë prej 3.4 përqind në vitin 2014 (tabela 1). Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2014 u dobësua veçanërisht në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, vende këto që priten të karakterizohen me rënie ekonomike prej 0.5 përqind respektivisht rritje të dobët prej 0.7 përqind në vitin 2014. Aktiviteti ekonomik në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar përgjithësisht me një performancë të dobët të prodhimit industrial dhe ngadalësim të shprehur në sektorin e ndërtimitarisë. Vlen të theksohet se reshjet e mëdha të shiut në pranverë dhe vërshimet që pasuan dëmtuan rëndë aktivitetin ekonomik në Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi.


Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kosova	7.2	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	3.0
Maqedonia	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.4	2.9	3.4
Serbia	3.8	-3.5	1.0	1.6	-1.5	2.5	-0.5
Shqipëria	7.5	3.4	3.5	2.3	1.1	0.4	2.1
Mali i Zi	6.9	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.5	2.3
Bosnja e H.	5.6	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.1	0.7

Burimi: FMN (WEO, 2014), për Kosovën të dhënat e ASK-së dhe vlerësimi i BQK-së për vitin 2014

Kërkesa përgjithësisht e dobët në rajon, përcjellë nga shkalla e ulët e inflacionit në nivel global si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare (veçanërisht të ushqimit), ka ndikuar që ambienti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor të karakterizohet me norma të ulëta të inflacionit. Sipas projeksioneve të fundit të FMN-së, si dhe trendit që përcollën çmimet në tetë muajt e parë të vitit 2014, Mali i Zi pritet të karakterizohet me deflacion prej 0.6 përqind. Me shkallë të ulët të inflacionit pritet të karakterizohen edhe vendet tjera, përfshirë edhe Serbinë e cila vazhdon të ketë normën më të lartë të inflacionit në rajon (2.3 përqind për vitin 2014) (figura 6).

Figura 6. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL



Burimi: FMN (2014) dhe parashikimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2014


¹ Ballkani Perëndimor përfshinë: Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnje Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi.

Tregjet e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të ndajnë si karakteristikë të përbashkët shkallën e lartë të papunësisë sidomos tek të rinjtë dhe femrat, si dhe papunësinë afatgjatë. Sipas FMN-së, në vitin 2014, shkalla mesatare e papunësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të jetë rreth 24 përqind. Kosova vazhdon të karakterizohet me shkallën më të lartë të papunësisë prej 30 përqind, përderisa Shqipëria pritet të kenë normën më të ulët të papunësisë prej 14 përqind në vitin 2014.

Sfidë e veçantë për vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet edhe shkalla e lartë e deficitit të llogarisë rrjedhëse që vazhdon ta karakterizojë sektorin e jashtëm të këtyre vendeve. Pothuajse të gjitha vendet pritet ta thellojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse me përjashtim të Serbisë e cila pritet të ketë një përmirësim të lehtë (figura 7). Ky thellim i deficitit të llogarisë rrjedhëse është kryesisht rezultat i rritjes më të ngadalësuar të eksporteve dhe përshpejtimit të rritjes së importeve. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të shënoj rritje prej mesatarisht 5.0 përqind (8.0 përqind ishte rritja në vitin e kaluar) ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve nga rritja prej mesatarisht 0.2 përqind në vitin e kaluar pritet të arrijë në 7.0 përqind.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, kryesisht si reflektim i dobësimit të aktivitetit ekonomik, vendet e rajonit si Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria raportuan rënie të aktivitetit kreditues (tabela 2). Në të njëjtën periudhë, lehtësimi i standardeve kreditore nga sektori bankar është përkthyer në rritje të portfolios kreditore në Maqedoni, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë.

Figura 7. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje të PBB-së



Burimi: FMN (2014)

Tabela 2. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor


Përshkrimi	Shqipëria		Bosnja e Hercegovina		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014
Kreditë	0.7	-1.8	3.2	3.7	3.6	7.8	4.8	-3.3	-2.9	-5.3	2.8	3.5
Depozitat	4.8	1.0	4.4	7.7	3.2	8.7	9.0	6.8	4.4	3.3	4.4	10.0

Burimi: Komisioni Evropian - Raporti i tremujorit të tretë 2014; për Kosovën të dhënat e BQK-së.

Sa i përket depozitave në sektorin bankar, Kosova dhe Maqedonia shënuan rritjen më të lartë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, përderisa Shqipëria raportoi normën më të ulët të rritjes së depozitave gjatë kësaj periudhe. Vendet në Ballkanin perëndimor raportuan rritje të kredive jo-performuese edhe gjatë vitit 2014. Nivelin më të lartë të kredive jo-performuese deri në qershor 2014 e raportuan Serbia dhe Shqipëria, prej 23.0 përkatësisht 24.1 përqind, përderisa nivelin më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon të raportoj Kosova prej mesatarisht 8.5 përqind (figura 8). Megjithatë, kreditë jo-performuese mbesin mirë të mbuluara nga provizionet dhe sektori bankar është mirë i kapitalizuar në vendet e Ballkanit perëndimor.

Sektori fiskal gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është karakterizuar me përmirësim të performancës buxhetore në Shqipëri dhe Mal të Zi, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave që rezultoi nga rritja e taksave (Shqipëri) dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar mbledhjen e të hyrave buxhetore. Realizimi i shpenzimeve në Shqipëri dhe Mal të Zi mbeti nën nivelin e planifikuar. Në anën tjetër, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina u përballën me realizim më të ulët të të hyrave buxhetore, si pasojë e përkeqësimit të tregut pas vërshimeve që pësuan në fillim të vitit 2014. Në Maqedoni, zhvillimet buxhetore u karakterizuan me rritje të shpenzimeve në tremujorin e parë të vitit 2014, megjithëse realizimi i shpenzimeve kapitale ishte nën nivelin e planifikuar. Një situatë e ngjashme e karakterizoi edhe Kosovën, me rritje të pagave dhe pensione dhe me zvogëlim të shpenzimeve kapitale. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (7.6 përqind të PBB-së) dhe Maqedonia (6.0 përqind të PBB-së), ndërsa vendet tjera pritet të kenë nivele më të ulëta të deficitit buxhetor. Borxhi publik në Ballkanin Perëndimor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 ka shënuar ngritje të lehtë nga mesatarisht 42.2 përqind e PBB-së në fund të vitit 2013 në 43.0 përqind në qershor 2014. Shqipëria dhe Serbia janë vendet me shkallën më të lartë të ngarkesës me borxhe publike (rreth 64 përqind e PBB-së) ndërsa Kosova ka shkallën më të ulët (10.2 përqind e PBB-së).

Figura 8. Norma e kredive joperformuese në EJL




Burimi: Komisioni Evropian (2014)

4. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e naftës (brent crude)² gjatë vitit 2014 shënuan rënie mesatarisht për 9.1 përqind krahasuar me vitin 2013 (figura 9). Faktori kryesor që ka ndikuar në rënien e çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 konsiderohet të ketë qenë rritja e theksuar e prodhimit të naftës në SHBA duke e bërë SHBA-në ndër prodhuesit kryesor në nivel global. Si rezultat i rritjes së prodhimit të brendshëm, SHBA ka zvogëluar kërkesën për import të naftës. Rritja e prodhimit të brendshëm dhe rënia e importit të këtij produkti nga SHBA-të ndikoi që kërkesa për importim të naftës të zvogëlohet, duke shkaktuar kështu edhe rënie të çmimit. Përveç kësaj, organizata OPEC (angl. Organization of Petroleum Exporting Countries) nuk ka arritur konsensus të brendshëm për zvogëlimin e prodhimit të naftës gjë që ka mundur vazhdimin e rënies së çmimit të këtij produkti.

Figura 9. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Banka Botrore (2015)

Projeksionet e EIA (2014) sugjerojnë se në vitin 2015 por edhe në vitin e ardhshëm këto çmime pritet të mbesin relativisht stabile. Kjo pasi që pritet se nuk do të ketë goditje nga ana e ofertës

² 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.


si rezultat i prodhimit të lartë në SHBA, përderisa vendet e Lindjes së Mesme vlerësohet se do të kenë nevojë të mbajnë nivele të larta të eksportit të naftës.

Rënia e çmimeve të naftës mund të ndikojë edhe në çmimet e mallrave të konsumit, sidomos atyre ushqimore, pasi që nafta dhe energjia përbëjnë komponentë mjaft të rëndësishëm në procesin e prodhimit dhe transportimit të tyre. Zvogëlimi i çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 pritet të ndikojnë pozitivisht në vendet importuese duke kontribuar në përmirësimin e bilancit të llogarive rrjedhëse. Ndryshimet në çmimet e naftës janë reflektuar edhe në deficitin e llogarisë rrjedhëse në Kosovë pasi që të dhënat tregojnë se sasia e importuar e naftës është rritur, ndërsa vlera nominale e pagesave për këtë produkt ka shënuar rënie të konsiderueshme.

4.1. Çmimet e arit

Gjatë vitit 2014 rënie kanë shënuar edhe çmimet e arit (figura 10). Çmimi i arit gjatë kësaj periudhe ka shënuar rënie për rreth 10.3 përqind. Çmimet e arit zakonisht ngriten në periudha kur ka nivel të lartë të inflacionit ose kur ekonomitë e mëdha ballafaqohen me krizë. Inflacioni gjatë vitit 2014 nuk ka qenë shqetësim, mirëpo shumë nga ekonomitë e mëdha janë ballafaquar me vështirësi. Sidoqoftë, këto vështirësi nuk kanë arritur të ndikojnë në rritje të çmimit të arit. Si arsye kryesore për mos rritjen e çmimit e arit në kushtet e performancës jo të mirë ekonomike në vendet e zhvilluara konsiderohet të ketë qenë zvogëlimi i normës bazë të refinancimit të BQE-së e cila ka ndikuar që dollari të forcohet ndaj euros. Forcimi i dollarit zakonisht përkthehet në kërkesë më të vogël për ari, gjë që ka parandaluar rritjen e çmimit të arit. Edhe gjatë vitit 2015, çmimet e arit pritet të jenë kryesisht stabile.

Figura 10. Çmimi i arit, në USD për unce




Burimi: Banka Botrore (2015)

4.2. Çmimet e metaleve dhe mineraleve

Rënia e çmimeve të produkteve kryesore është reflektuar edhe në çmimet e metaleve dhe mineraleve që gjatë viteve të fundit u karakterizuan me ndryshime të vogla dhe tendencë rënëse. Gjatë vitit 2014, indeksi i çmimit të metaleve dhe mineraleve ka shënuar rënie prej 6.6 përqind (figura 11). Çmimet e nikelit dhe zinkut u karakterizuan me rritje të konsiderueshme prej 13.1 përkatësisht 12.4 përqind. Edhe çmimet e aluminit u karakterizuan me ngritje të lehtë prej 1.1 përqind, ndërsa çmimet e bakrit dhe plumbit u karakterizuan me rënie prej 6.4 përkatësisht 2.1 përqind. Lëvizjet në çmimet e metaleve reflektohen edhe në ekonominë e Kosovës pasi që metalet bazë kanë një pjesëmarrje të lartë në gjithsej eksportin e Kosovës.

Figura 11. Indeksi i çmimeve të metaleve




Burimi: Banka Botrore (2015)

4.3. Çmimet e prodhimeve ushqimore

Çmimet e ushqimit kanë vazhduar trendin e rënies, trend ky i cili filloi që nga qershori 2013. Indeksi i çmimeve të ushqimit gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rënie për 3.7 përqind (figura 12). Indeksi i çmimeve të drithërave ka shënuar rënie prej 12.5 përqind, e cila pjesërisht mund të shpjegohet me rënien prej 9.1 përqind të çmimeve të naftës por edhe për shkak të ofertës mjaftë të lartë në nivel global. Pritjet për vitin 2015 janë se çmimet e produkteve ushqimore do të vazhdojnë të jenë relativisht të ngjashme me vitin 2014 si rezultat i ofertës stabile (FMN, 2014).

Figura 12. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithrave



Burimi: FAO (2015)

5. Ekonomia e Kosovës

5.1. Çmimet

Ngjashëm me zhvillimet në tregjet globale, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me trend rënës të inflacionit gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), deri në qershor 2014 ishte 0.3 përqind, që është më e ulët se sa norma prej 2.7 përqind e shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Kontributin³ kryesor në këtë nivel të inflacionit deri në qershor 2014 e kishin energjia me 0.7 pikë përqindje dhe pijet alkoolike dhe duhani me 0.6 pikë përqindje, ndërsa veshmbathja, ushqimi dhe pijet joalkoolike kontribuuan negativisht me 0.5 përkatësisht 0.1 pikë përqindje (figura 13). Kjo rënie shkallës së inflacionit është reflektuar kryesisht përmes nivelit më të ulët të rritjes së çmimeve të mallrave të importuara që është rezultat i presioneve deflacioniste në vendet e eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare.

5.1.1 Struktura e inflacionit dhe inflacioni bazë

Në gjysmën e parë të vitit 2014, rritje të çmimeve shënuan pijet alkoolike dhe duhani me 4.8 përqind, veshmbathja me 3.3 përqind, energjia me 2.4 përqind, restorantet dhe hotelet me 2.4 përqind, etj., ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizua transporti me 1.4 përqind, kryesisht për shkak të rënies së çmimit të derivateve të naftës. Përveç çmimeve të transportit, me rënie u karakterizuan edhe çmimet e mjeteve të komunikimit, ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat shënuan rënie të çmimit prej 1.2 përqind secila.

Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit shënoj rritje të çmimeve prej 4.8 përqind. Në kuadër të kësaj kategorie, çmimet e duhanit shënuan rritje prej 6.3 përqind, ndërsa çmimet e alkoolit shënuan rënie për 1.1 përqind. Rritja e çmimeve të duhanit është kryesisht

Figura 13. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulime të BQK-së (2014)

Figura 14. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan në euro





Figura 15. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tij, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

³ Kalkulimi i kontributit të komponentëve të IÇK-së në nivelin e inflacionit, përveç lëvizjes së çmimeve, bazohet edhe në peshën që kanë komponentët e caktuar në IÇK.

rezultat i vendimit të qeverisë për rritje të akcizës së duhanit nga 30 në 32 euro për njësi duke filluar nga janari 2014. Siç edhe është paraqitur në figurën 14, lëvizjet në çmimet e duhanit në Kosovë përcaktohen në masë të konsiderueshme nga akciza e aplikuar për këtë produkt. Në anën tjetër, kategoria e ushqimit dhe pijeve joalkoolike deri në qershor 2014 shënoj rënie për 1.2 përqind përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraparak kishin shënuar rritje për 4.2 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rënia më e theksuar e çmimeve është shënuar tek vajrat dhe yndyrat me 11.4 përqind dhe buka dhe drithërat me 5.5 përqind, ndërsa për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike, çmimet e pemëve shënuan rritje për 3.9 përqind (figura 15).

Çmimet e strehimit, ujit, rrymës dhe lëndëve tjera djegëse deri në qershor 2014 shënuan rritje mesatare prej 2.3 përqind (1.4 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraparak). Kjo rritje më e lartë e çmimeve të kësaj kategorie krahasuar me vitin paraparak ishte për shkak të rritjes së çmimeve të strehimit prej 5.9 përqind si dhe rritjes së çmimit të rrymës dhe lëndëve tjera djegëse prej 2.6 përqind. Rritje të çmimeve prej 0.8 përqind shënoi edhe furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (figura 16).

Lëvizja e çmimeve të nën-kategorisë së rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse është në masë të konsiderueshme e përcaktuar nga çmimi i energjisë për KWh. Siç edhe është paraqitur në figurën 17, indeksi i çmimit të energjisë, i cili karakterizohet me ndryshime të theksuara (varësisht nga tarifa verore dhe dimërore), është karakterizuar me trend rritës.

Mesatarja vjetore e çmimeve të shërbimeve deri në qershor 2014 ishte pothuajse e ngjashme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak. Megjithatë, përbrenda kategorisë së shërbimeve kishte lëvizje të ndryshme të çmimeve. Rritje e çmimeve është shënuar tek shërbimet e hotelierisë prej 2.4 përqind si dhe shërbimet shëndetësore dhe të rekreacionit për 0.2 përkatësisht 0.1 përqind. Në anën tjetër, çmimet e shërbimeve të transportit dhe të komunikimit shënuan rënie për 1.4 përkatësisht 1.2 përqind, përderisa çmimet e shërbimeve arsimore mbetën të pandryshuara (figura 18).

Figura 16. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë, rritja vjetore në përqindje




Figura 17. Indeksi i çmimit të energjisë dhe çmimi për KWh





Figura 18. Çmimet e shërbimeve, rritja vjetore në përqindje



Shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje mjaft të lartë të produkteve të cilat kanë lëvizje sezonale të çmimeve. Këtu përfshihen ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani të cilat përbëjnë rreth gjysmën e shportës së konsumatorit. Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e çmimeve gjatë viteve të kaluara jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar (tabela 3). Kjo bënë që ndikimi i këtyre kategorive në gjithsej lëvizjen e çmimeve të jetë më i lartë se sa në vendet tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të ulët të këtyre kategorive në shportën e konsumatorit. Sidoqoftë, në vitet e fundit vërehet një stabilitet i çmimeve të këtyre produkteve por edhe tendencë rënëse në nivelin e pjesëmarrjes në gjithsej shportën e konsumatorit.

Tabela 3. Ndarja e IÇK-së

Përshkrimi	Peshat 2013	Mesatarja vjetore e rritjes, në përqindje						
		Qer 2008	Qer 2009	Qer 2010	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2014
IÇK	100.0%	12.7	-2.6	1.4	9.6	1.5	2.7	0.3
<i>Ndarja e IÇK-së:</i>								
Ushqimi	37.8%	23.5	-4.8	1.0	16.9	-1.3	4.0	-1.2
Energjia	7.1%	4.1	5.2	4.9	1.5	7.9	1.4	2.3
Mallrat tjerë	22.4%	-0.1	3.6	-1.5	4.7	4.6	4.7	3.3
Shërbimet	32.7%	2.5	-3.1	1.8	3.3	1.6	1.5	0.7
<i>Inflacioni bazë, përjashtuar:</i>								
Ushqimin	62.2%	4.2	-0.7	1.0	3.1	2.1	1.1	0.8
Ushqimin dhe energjinë	55.1%	3.9	-1.0	0.7	3.0	1.6	1.0	0.6
Ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin	49.9%	3.9	-1.4	0.9	2.5	1.1	0.4	0.3


Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me ndryshim më të theksuar të çmimeve, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë (figura 19). Më specifikisht, inflacioni bazë, i cili përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin deri në qershor 2014 ka rënë në 0.3 përqind nga 0.4 përqind sa ishte në vitin paraprak. Inflacioni bazë historikisht ka qenë më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm, ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2014 për shkak të rënies së çmimeve të ushqimit inflacioni bazë është pothuajse i njëjtë me inflacionin e përgjithshëm (tabela 3).

5.1.2 Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe të pa tregtueshme


Lëvizja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe atyre të pa tregtueshme historikisht ka qenë e ngjashme, ndërkohë që në dy vitet e

Figura 19. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

Figura 20. Pjesëmarrja e komponenteve të tregtueshme dhe të patregtueshme në komponentët e IÇK-së




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

fundit vërehet një stabilitet më i madh të çmimit të mallrave dhe shërbimeve të pa tregtueshëm. Deri në qershor 2014, mallrat dhe shërbimet e pa tregtueshme shënuan rënie prej 0.3 përqind krahasuar me rënie prej 0.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, mallrat dhe shërbimet e tregtueshme deri në qershor 2014 shënuan rritje prej 0.1 përqind krahasuar me rritjen prej 3.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie e inflacionit të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme është kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të importit.

Meqenëse ekonomia e Kosovës është ekonomi e vogël, është e natyrshme që komponentët e tregtueshëm të mallrave dhe shërbimeve të kenë një pjesëmarrje të lartë. Komponentët e tregtueshëm⁴ përbëjnë rreth 74 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, ndërsa komponentët e pa tregtueshëm (kryesisht shërbimet) përbëjnë rreth 26 përqind (figura 20). Rrjedhimisht, siç shihet edhe në figurën 21, lëvizja e çmimeve të përgjithshme në Kosovë është më shumë e përcaktuar nga komponentët e tregtueshëm se sa nga komponentët e pa tregtueshëm.

Figura 21. IÇK gjithsej dhe komponentët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm




Burimi: ASK dhe kalkulime të BQK-së (2015)

5.1.3 Çmimet e importit, çmimet e prodhimit dhe norma reale efektive e këmbimit

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë janë mjaft të ngjashme me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo konfirmohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me indeksin e çmimeve të konsumit (figura 22). Mesatarja e çmimeve të importit gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 ka shënuar rënie për 0.2 përqind (1.0 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2013). Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 me nga 23.0 përqind secila, pasuar nga metalet bazë me 11.6 përqind, pastaj produktet e industrisë kimike me 7.1 përqind, etj. Në anën tjetër, çmimet e tekstilit kanë shënuar rënie më të lartë prej 24.6 përqind, pasuar nga mjetet e transportit me 8.0 përqind, si dhe artikujt ushqimor të përgatitur me 7.4 përqind. Edhe produktet minerale të cilat përbëhen kryesisht nga nafta dhe derivatet e saj shënuan rënie për 6.4 përqind krahasuar me rënie prej 1.4 të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 22. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)

Çmimet e prodhimit shënuan rënie prej 0.6 përqind (4.8 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2013). Kjo rënie e çmimeve të prodhimit më së shumti u nxit nga rënia e çmimeve të cilat

⁴ Komponentët e tregtueshëm konsiderohen mallrat dhe shërbimet të cilat tregtohen edhe në tregjet ndërkombëtare ndërsa të patregtueshme janë ato mallra dhe shërbime të cilat konsumohen vetëm brenda vendit dhe nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare. Rrjedhimisht, edhe faktorët që ndikojnë në çmime dallojnë tek komponentët e tregtueshëm dhe ata të patregtueshëm. Komponentët e patregtueshëm ndikohen nga faktorë të tillë si kërkesa dhe oferta vendore ndërsa komponentët e tregtueshëm përveç ofertës dhe kërkesës vendore ndikohen edhe nga çmimet botërore të cilat formohen nga oferta dhe kërkesa ndërkombëtare.

konsiderohen si çmime të administruara siç janë nxjerrja e qymyrit dhe linjtit të cilat shënuan rënie prej 19.3 përqind, pasuar nga rënia e çmimeve të prodhimit të pajisjeve elektrike prej 13.9 përqind, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (7.9 përqind rënie). Rënie prej 0.7 përqind shënuan edhe çmimet e energjisë, të cilat konsiderohet se kanë një pjesëmarrje të madhe në çmimet e prodhimit. Ndikimi i rënies së çmimeve të këtyre kategorive në gjithsej çmimet e prodhimit u reduktua deri diku nga rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve kimike prej 23.6 përqind, pastaj rritjes së çmimeve të prodhimit të tekstilit prej 10.1 përqind, prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit prej 9.3 përqind, etj.


Norma reale efektive e këmbimit (NREK) të euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtarë, e cila bazohet në çmimet e konsumit, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 u vlerësua për mesatarisht 0.5 përqind, që është kryesisht rezultat i inflacionit më të lartë në Kosovë se sa në vendet partnere tregtare. NREK u vlerësua për 0.4 përqind ndaj vendeve të CEFTA-s ndërsa u zhvlerësua për 0.3 përqind ndaj vendeve të BE-së, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë zvogëluar konkurrueshmërinë ndaj vendeve të CEFTA-së përderisa e kanë rritur konkurrueshmërinë ndaj vendeve të BE-së.

5.2. Produkti i brendshëm bruto

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 vlerësohet të ketë shënuar normë reale të rritjes prej 3.0 përqind (figura 23). Rritja ekonomike gjatë vitit 2014 vlerësohet të jetë gjeneruar nga konsumi privat dhe publik, ndërkohë që investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike. Vlera nominale e PBB-së, sipas vlerësimeve të BQK-së, ishte 5.5 miliard euro në vitin 2014.


Konsumi i përgjithshëm, si komponenta kryesore e PBB-së në Kosovë me një pjesëmarrje prej 107.0 përqind, vlerësohet të jetë karakterizuar me rritje prej 5.8 përqind në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak (figura 24). Kjo rritje e përshpejtuar e konsumit mbështetet kryesisht në rritjen e konsumit privat prej 5.8 përqind gjatë kësaj periudhe, kryesisht si rezultat i peshës më të madhe që ka (84.5 përqind) në gjithsej konsumin. Rritja e konsumit privat prej 5.8 përqind i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, përderisa rritja e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë (konkretisht pagave dhe mëditjeve dhe subvencioneve e transfereve) vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e konsumit publik prej 6.2 përqind dhe rrjedhimisht, konsumit të përgjithshëm në vend.

Figura 23. Rritja reale e PBB-së



* Të dhënat për vitin 2014 paraqesin vlerësimet e BQK-së Burimi: ASK (2015)

Figura 24. Komponentat kryesore të PBB-së, vlera nominale, në miliardë euro



* Të dhënat për vitin 2014 paraqesin vlerësimet e BQK-së Burimi: ASK (2015)

klimatike në muajt e parë të vitit 2014. Rënia më e theksuar është shënuar për sektorin e amvisërisë, konsumi i të cilit ka shënuar rënie prej 6.8 përqind. Me rritje të konsumit është karakterizuar vetëm kategoria e konsumatorëve 220-110 kv, që përfshinë kryesisht tregtimin e energjisë në shtete tjera. Me rënie të konsumit në energji janë karakterizuar edhe industria dhe ndërmarrjet publike me 5.9 përkatësisht 3.0 përqind. Ndërsa, konsumatorët komercial kanë mbajtur nivel relativisht të ngjashëm të konsumit.

Në gjysmën e parë të vitit 2014, Kosova ka realizuar bilanc pozitiv të energjisë prej 126.3 GWh. Eksporti i energjisë ka arritur në 404.7 GWh që është për 17.9 përqind më pak se sa eksporti i shënuar në periudhën e njëjtë të vitit 2013 ndërsa importi i energjisë ka shënuar rritje për 20.1 përqind dhe ka arritur nivelin prej 278.4 GWh. Krahasuar me vitin 2013, bilanci i energjisë paraqet një rënie të theksuar (51.7 përqind), por duhet të merret parasysh fakti se në viti 2013 është shënuar niveli më i lartë i eksportit dhe prodhimit të energjisë së regjistruar ndonjëherë. Që nga viti 2008, Kosova kryesisht është karakterizuar me bilanc negativ në energji, prandaj, mbajtja e bilancit pozitiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 ka paraqitur zhvillim pozitiv për sektorin e energjisë në vend.


Transporti

Transporti i udhëtarëve nëpërmjet hekurudhave në Kosovë ka qenë relativisht stabil gjatë viteve të fundit. Mesatarisht, gjatë viteve, transportin hekurudhor e përdorin rreth 360 mijë pasagjer ose rreth 90 mijë pasagjer për një tremujor (figura 27). Në gjysmën e parë të vitit 2014, numri i pasagjerëve që përdorin transportin hekurudhor ka pasur rritje prej 2.2 përqind.

Sa i përket transportit të mallrave përmes hekurudhave, trendet kanë qenë më të luhatshme gjatë viteve. Mesatarisht gjatë një tremujori transportohen mbi 200 ton mallra përmes hekurudhave. Në gjysmën e parë të vitit 2014, sasia e mallrave të transportuara përmes hekurudhave të Kosovës ishte 385 ton krahasuar me 503 ton në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Sa i përket transportit ajror, gjysma e parë e viti 2014 u karakterizua me rënie të numrit të udhëtarëve dhe fluturimeve. Rënia e numrit të fluturimeve ishte 23.3 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, ndërsa numri i udhëtarëve gjatë kësaj periudhe shënoi rënie vjetore prej 18.6 përqind (figura 28).

Figura 27. Transporti hekurudhorë në Kosovë



Burimi: ASK (2015)

Figura 28. Transporti ajror në Kosovë



Burimi: ASK (2015)

Prodhimi/Industria


Të dhënat e indeksit për prodhimin industrial kanë filluar të publikohen nga ASK gjatë vitit 2014. Këto të dhëna kanë për vit bazë vitin 2012, ndërsa indeksi tregon për rritje të vazhdueshme të prodhimit në industrinë nxjerrëse dhe sjellje relativisht stabile të industrisë përpunuese. Sa i përket sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, ngrohjes dhe gazit, trendet kanë qenë kryesisht mjaft pozitive duke u karakterizuar me rritje mjaft të lartë.

5.3.1 Sektori i Ndërmarrjeve

Zhvillimet në kuadër të ndërmarrjeve private gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 u karakterizuan me rënie të numrit të ndërmarrjeve të reja në regjistrin e bizneseve dhe rritje të numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i gjithsej ndërmarrjeve të reja deri në qershor 2014 ishte 5,311 krahasuar me 5,605 deri në qershor 2013. Numri i bizneseve të mbyllura deri në qershor 2014 arriti në 881 krahasuar me 762 sa ishte deri në qershor 2013. Ndërmarrjet e mbyllura gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 përbënin 16.6 përqind të gjithsej ndërmarrjeve të reja, krahasuar me 13.6 përqind në gjysmën e parë të vitit 2013. Raporti ndërmjet ndërmarrjeve të reja dhe atyre të mbyllura në Kosovë mesatarisht vazhdon të jetë më i favorshëm se sa në vendet tjera. Ky raport në Kosovë tregon se mesatarisht 1.6 biznese mbyllen nga 10 biznese që hapen, ndërsa vendet tjera ballafaqohen me mbi 3 mbyllje të bizneseve në çdo 10 biznese që hapen brenda vitit të parë.


Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve të reja, trendi ka vazhduar të jetë relativisht i ngjashëm me vitet paraprake. Ndërmarrjet tregtare vazhdojnë të dominojnë strukturën e ndërmarrjeve të reja dhe përfaqësojnë rreth 31 përqind të gjithsej ndërmarrjeve. Sidoqoftë, vërehet një rritje më e theksuar e ndërmarrjeve përpunuese, pjesmarrja e të cilave është rritur në 11.4 përqind nga 5.2 përqind sa ka qenë në vitin 2013.

Figura 29. Indeksi i prodhimit industrial




Burimi: ASK (2015)

Figura 30. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2015)

Figura 31. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2015)


5.4. Sektori i jashtëm

Rikuperimi i brishtë ekonomik në eurozonë dhe performanca e përkeqësuar në vendet e Ballkanit Perëndimor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 u reflektua edhe në aktivitetin tregtar të ekonomisë së Kosovës. Dobësimi i kërkesës së jashtme dhe rënia e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 është përkthyer në përkeqësim të pozicionit të neto eksporteve në vend në këtë periudhë. Bilanci i pagesave në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të pozicionit të jashtëm kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale dhe zvogëlimit të flukseve në llogarinë financiare gjatë kësaj periudhe. Deri në qershor 2014, llogaria rrjedhëse u karakterizua me rritje të deficitit në llogarinë e mallrave, zvogëlim të bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve dhe në llogaritë e të ardhurave parësore dhe dytësore.⁵ Rritja e deficitit tregtar i atribuohet kryesisht rënies së aktivitetit tregtar gjatë kësaj periudhe, shprehur përmes rënies së vlerës së gjithsej eksporteve dhe rritjes së dobët të importeve në vend. Rënia e vlerës së eksporteve të Kosovës deri në qershor 2014 kryesisht reflekton rënien e çmimit të mallrave kryesore që Kosova eksporton, si dhe rënien e kërkesës së jashtme, sidomos nga vendet e rajonit dhe eurozona. Ndërkohë, deri në qershor 2014, importet e mallrave janë karakterizuar me rritje më të ngadalshme vjetore, ndikuar kryesisht nga rënia e vlerës së importeve të produkteve minerale si pasojë e rënies së çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare. Më kuadër të bilancit të pagesave të Kosovës, llogaria e shërbimeve u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, kryesisht si pasojë e rritjes më të shpejtë të importeve të shërbimeve gjatë kësaj periudhe kundrejt rritjes më të ngadalshme të eksporteve. Një ndër burimet më të qëndrueshme të financimit për konsum të ekonomive familjare në Kosovë mbeten remitencat, bilanci pozitiv i të cilave vazhdon të kontribuoj në zvogëlimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, remitencat janë karakterizuar me rritje të konsiderueshme prej rreth 7 përqind, rritje që është reflektuar në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend jo vetëm përmes stimulimit të konsumit, por edhe të investimeve private. Në kuadër të llogarisë financiare, kategoria e investimeve të huaja direkte vazhdon të mbetet kontribuues kryesor në bilancin pozitiv të kësaj llogarie. Megjithatë, vlera e gjithsej IHD-ve të pranuar në Kosovë deri në qershor 2014 ishte dukshëm më e ulët krahasuar me vlerën e shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i vlerës së IHD-ve në vend në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, ndër të tjera, i atribuohet shitjes së aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë rezidentëve kosovar por edhe shpërndarjes së superdividendës⁶ së disa prej kompanive.

5.4.1 Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale

Dinamika e zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse të Kosovës vazhdon të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të vendit. Në gjysmën e parë të vitit 2014, pozicioni i llogarisë rrjedhëse në Kosovë u përkeqësua si pasojë e rritjes së deficitit në tregtinë e mallrave, përderisa bilanci pozitiv në tregtinë e

Figura 32. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

⁵ Në kuadër të Bilancit të Pagesave të Kosovës, llogaria e të ardhurave parësore përfshinë kategoritë "Kompenzimi i punonjësve" dhe "Të ardhurat nga investimet". Llogaria e të ardhurave dytësore përbëhet nga "Transferet për Qeverinë" dhe "Transferet Private – që dominohen nga remitencat".

⁶ Me superdividendë nënkuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

shërbimeve dhe kategorive si të ardhurat primare dhe sekondare vazhdojnë të kontribuojnë në ngushtimin e këtij deficiti. Në gjysmën e parë të vitit 2014, deficiti në llogarinë rrjedhëse është rritur në 7.1 përqind të PBB-së, nga 4.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Deficiti në llogarinë rrjedhëse arriti vlerën prej 198.1 milion euro në qershor 2014, që paraqet një rritje të konsiderueshme vjetore prej 69.1 përqind (figura 32). Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht pasojë e rritjes së deficitit tregtar, si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe llogarisë së të ardhurave primare dhe sekondare.


Një ndër problemet kryesore strukturore të ekonomisë së vendit mbetet përmirësimi i qëndrueshëm i bilancit të llogarisë rrjedhëse, gjë e cila kërkon rritje të mëtejme të kapaciteteve prodhuese në vend dhe rritje të konkurrueshmërisë së produkteve vendore si brenda vendit ashtu edhe në tregun e jashtëm.

Bilanci i llogarisë kapitale⁷ deri në qershor të vitit 2014, u zvogëlua në 0.9 milion euro, nga 13.7 milion euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i llogarisë kapitale gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet zvogëlimit të granteve për investime kapitale gjatë kësaj periudhe.

Mallrat dhe shërbimet

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014, aktiviteti tregtar i vendit u karakterizua me rënie të vlerës së eksporteve dhe një ritëm të dobët të rritjes së vlerës së gjithsej importeve. Duke arritur vlerën prej 793.8 milion euro (28.9 përqind e PBB-së), deficiti tregtar në mallra dhe shërbime ishte më i lartë për 3.2 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përderisa kategoria e mallrave u karakterizua me rënie të eksporteve dhe rritje të lehtë të

Figura 33. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

importeve, kategoria e shërbimeve shënoi rritje më të shpejtë të importeve kundrejt rritjes së eksporteve në gjysmën e parë të vitit 2014. Aktiviteti tregtar në vend u karakterizua me rënie të eksporteve dhe rritje të lehtë të importeve të mallrave në gjysmën e parë të vitit 2014, përderisa rritja e vlerës së eksporteve të shërbimeve u neutralizua deri në një masë nga rritja më e shpejtë e vlerës së importeve të shërbimeve gjatë kësaj periudhe. Në gjysmën e parë të vitit 2014, shkalla e hapjes tregtare, gjegjësisht raporti i aktivitetit tregtar të Kosovës ndaj PBB-së arriti në rreth 60.3 përqind, nga 59.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Mallrat

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën 932.0 milion euro në gjysmën e parë të vitit 2014, që paraqet një rritje prej 2.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 34). Rënia e vlerës së mallrave të eksportuara nga Kosova kundrejt rritjes së lehtë të mallrave të importuara në vend ka ndikuar që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet të zvogëlohet në 12.4 përqind në qershor 2014, nga 13.1 përqind sa ishte në qershor të vitit paraprak.


⁷ Llogaria kapitale paraqet të gjitha transaksionet që involvojnë pranimet ose pagesat e (1) transfertave kapitale dhe (2) transaksionet në mjetet jo prodhuese - jo financiare (siç janë patentat, dhe të drejtat e autorit).

Pjesëmarrja e eksporteve të Kosovës në gjithsej PBB vijoi të mbetet e ulët prej vetëm rreth 5 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014. Gjatë kësaj periudhe, gjithsej eksportet e Kosovës u zvogëluan për 5.9 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 141 milionë euro (figura 35). Përderisa në vitin paraprak rritja e vlerës së eksporteve të mallrave i'u atribuua kryesisht rritjes së përgjithshme të kërkesës në rajon dhe në vendet e BE-së si dhe rritjes së çmimeve të komponentëve kryesor që Kosova eksporton, në gjysmën e parë të vitit 2014 ishin pikërisht këta dy faktorë që ndikuan në rënien e eksportit.

Struktura e eksporteve të Kosovës vazhdon të dominohet nga kategoria e metaleve bazë, e cila në gjysmën e parë të vitit 2014 zvogëloi pjesëmarrjen në gjithsej eksportet në 47.2 përqind nga 50.8 përqind sa ishte në gjashtëmuorin e parë të vitit paraprak. Zvogëlimi i eksportit të këtyre mallrave kryesisht ishte pasojë e rënies së çmimeve të metaleve gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, rënia e prodhimit dhe, si pasojë, rënia e eksportit të energjisë elektrike në periudhën raportuese është reflektuar deri në një masë në rënien e vlerës së eksporteve të kategorisë së produkteve minerale, që në qershor kishin një pjesëmarrje prej 16.0 përqind në gjithsej eksportet e vendit (15.8 përqind në qershor 2013). Me rënie të vlerës së eksporteve deri në qershor të vitit 2014 u karakterizuan edhe kategoritë e produkteve plastike, të gomës dhe të tjera si dhe eksportet e makinerive, paisjeve mekanike dhe elektrike, rënie kjo që mund t'i atribuohet deri në një masë dobësimit të kërkesës së jashtme gjatë kësaj periudhe. Përndryshe, eksportet e produkteve bujqësore, pijeve dhe duhanit, dhe produkteve të tekstilit gjatë kësaj periudhe shënuan rritje.


Importet vazhdojnë të kenë një pjesëmarrje të lartë në gjithsej PBB prej rreth 41 përqind në qershor 2014. Në gjysmën e parë të vitit 2014, vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë ishte 1.14 miliard euro, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 0.7 përqind (figura 36). Dinamika më e dobët e rritjes së vlerës së gjithsej importeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 kryesisht i atribuohet rënies së çmimeve të produkteve kryesore të importit, konkretisht produkteve minerale dhe produkteve të metaleve bazë. Vlera e importeve të produkteve minerale, që kanë njëherësh edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej importet në vend (18.0 përqind deri në qershor 2014) dhe kryesisht dominohen nga nafta, shënoi rënie gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizua edhe vlera e gjithsej importeve të metaleve bazë që gjithashtu i atribuohet kryesisht rënies së çmimeve të metaleve në këtë periudhë. Në anën tjetër, rënia e vlerës së importeve të produkteve kimike dhe importeve të

Figura 34. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve



Burimi: FMN (2014) dhe ASK (2014)

Figura 35. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit




Burimi: BQK (2014) dhe IFS dhe FAOUN

mjeteve të transportit deri në qershor 2014 jep indikacione për ngadalësim të aktivitetit ekonomik në sektorin e industrisë përpunuese në këtë periudhë. Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale mbetet e ulët prej rreth 8.5 përqind. Në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak, importi i mallrave të ndërmjetme është zvogëluar përderisa importi i mallrave për konsum gjatë kësaj periudhe është rritur. Mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të strukturës së gjithsej mallrave të importuara në vend (rreth 51 përqind), përderisa mallrat për konsum kanë një pjesëmarrje prej rreth 35 përqind. Pjesëmarrja e mbetur prej rreth 5.6 përqind i takon mallrave të pakegorizuara të importit.

Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës vazhdojnë të jenë shtetet e BE-së. Importet me origjinë nga BE-ja përfaqësojnë 42 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Deri në qershor të vitit 2014, pjesa më e madhe e importeve ka ardhur nga Gjermania, Italia dhe Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Kosova importon sasi të konsiderueshme të mallrave nga Turqia dhe Kina. Ndërkaq, në kuadër të vendeve të rajonit, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia.

Në anën tjetër, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së përfshijnë rreth 38 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës dhe janë të përqendruara kryesisht në Itali dhe në masë më të vogël në Gjermani. Sa i përket vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë më shumë në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni. Një pjesëmarrje e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës ka për destinacion edhe Indinë dhe Turqinë (figura 36).

Figura 36. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sikurse në periudhat paraprake, Kosova vazhdon të importojë produktet minerale kryesisht nga Italia dhe Greqia, përderisa nga Gjermania importon makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, mjete të transportit, produkte të plastikës, duhan etj. Nga partnerët tregtar në rajon, konkretisht nga Serbia dhe Maqedonia, Kosova importon kryesisht produkte minerale, pajisje mekanike dhe elektrike, produkte të qeramikës, pije dhe produkte ushqimore, etj. Nga vendet tjera evropiane dhe Azia, konkretisht nga Turqia dhe Kina, importi përbëhet kryesisht produktet e hekurit dhe çelikut, pajisjet mekanike dhe elektrike, produktet e qeramikës, tekstilit, etj. Sa i përket eksporteve, në Shqipëri vazhdon të eksportohet kryesisht hekur dhe çelik si dhe artikuj të tyre, metale bazë, produkte të plastikës, pije, produkte minerale, etj. Në Mal të Zi dhe Maqedoni, Kosova eksporton kryesisht metale bazë, duhan, produkte të tekstilit, artikuj të letrës, artikuj të gurit dhe qeramikës, etj.

Shërbimet

Bilanci i shërbimeve kishte vlerën prej 138.2 milionë euro në qershor 2014, një zvogëlim krahasuar me bilancin e shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 1.5 përqind. Zvogëlimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve në këtë periudhë kryesisht reflekton rritjen më të shpejtë të pagesave të rezidentëve Kosovar ndaj jo rezidentëve, kundrejt rritjes së të hyrave nga shitja e shërbimeve të jorezidentët. Llogaria e shërbimeve realizoi të hyra në vlerë prej 289.4 milionë euro, një rritje prej 12.6 përqind krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit paraprak. Ndërsa, gjithsej pagesat për shërbimet e shfrytëzuara nga jashtë arritën vlerën prej 151.2

milione euro, që paraqet një rritje më të lartë të shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak prej 29.4 përqind.

Në kuadër të bilancit të shërbimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit (figura 37). Deri në qershor 2014, bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 136.6 milionë euro, që krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak paraqet një rritje vjetore prej 17.8 përqind. Megjithëse shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje të njëtrajtshme të eksportit dhe importit, pesha më e lartë e eksporteve në kategorinë e udhëtimit ndikoi që bilanci i përgjithshëm i këtyre shërbimeve të

shënojë rritje. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit arritën vlerën prej 173.8 milion euro, një rritje vjetore prej 21.2 përqind, dhe kryesisht përbëhen prej shpenzimeve të jorezidentëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, pagesat për shërbimet e udhëtimit të rezidentëve kosovar arritën vlerën prej 37.2 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 35.7 përqind.


Në gjysmën e parë të vitit 2014, bilanci i shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit u karakterizua me zvogëlim të bilancit në 16.4 milionë euro nga 18.9 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2013. Gjithashtu, me bilanc më të ulët të shërbimeve u karakterizuan edhe kategoria e shërbimeve tjera të biznesit dhe shërbimet qeveritare, që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 kishin vlerën prej 8.9 përkatësisht 6.0 milion euro (10.9 përkatësisht 13.1 milion euro në gjysmën e parë të vitit 2013). Bilanci i shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit u zvogëlua gjatë kësaj periudhe kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të kompanive të komunikimit në ekonominë e Kosovës, që mund të ketë rezultuar nga avancimi i vazhdueshëm i teknologjisë në kontekst të produkteve të reja që ofrohen pa pagesë. Gjithashtu, shërbimet për qeverinë u zvogëluan kryesisht si pasojë e zvogëlimit të vazhdueshëm të prezencës ndërkombëtare në Kosovë (misionet diplomatike, Eulex dhe KFOR), përderisa në të njëjtën kohë, pagesat për rezidentët kosovar në misionet diplomatike jashtë vendit shënuan rritje.

Në kuadër të bilancit të shërbimeve, shërbimet e realizuara për procesim të mallrave arritën vlerën prej 2.9 milion euro në gjashtëmujorin e parë, një rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur këto shërbime kishin vlerën prej 2.4 milion euro.

Të ardhurat parësore

Llogaria e të ardhurave parësore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 kishte një bilanc pozitiv prej 62.8 milionë euro, edhe pse ky bilanc ishte më i ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak për rreth 16.2 përqind. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, të hyrat në kuadër të llogarisë së të ardhurave u zvogëluan në 102.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 8.8 përqind. Në anën tjetër, pagesat u rritën për 5.9 përqind, duke arritur vlerën prej 40.0 milionë euro.


Figura 37. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Zvogëlimi i bilancit pozitiv në llogarinë e të ardhurave parësore ishte kryesisht pasojë e rritjes së lehtë të pagesave dhe rënies së të hyrave në kuadër të llogarisë së kompenzimit të punëtorëve (figura 38). Të hyrat nga kompenzimi i punëtorve, që kryesisht përbëhen nga të ardhurat e punëtorëve jashtë vendit siç janë punëtorët sezonal si dhe punëtorët në Afganistan dhe Irak janë kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave primare. Deri në qershor të vitit 2014, të hyrat nga kompenzimi i punonjësve arritën vlerën prej 98.9 milionë euro (110.0 milionë euro deri në qershor 2013). Në të njëjtën periudhë, pagesat për kompenzimin e punëtorëve që përfshijnë punëtorët jorezident të angazhuar në Kosovë për periudhë më pak se një vit shënuan vlerën 2.9 milionë euro, krahasuar me 1.8 milionë euro sa ishin në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013.

Figura 38. Të ardhurat parësore, në milionë euro




Deri në qershor të vitit 2014, të ardhurat nga investimet jashtë vendit kishin një bilanc negativ prej 33.7 milionë (33.3 milion euro deri në qershor të vitit 2013). Të hyrat në kuadër të të ardhurave nga investimet u rritën në 3.4 milionë euro në gjashtëmuajorin e parë 2014 (2.7 milion euro në gjashtëmuajorin e parë 2013), përderisa pagesat rritën vlerën në 37.1 milion në të njëjtën periudhë (36.0 milionë euro në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013). Të hyrat nga investimet përbëhen kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore (letra me vlerë, depozita, etj.) në tregjet e jashtme, ndërkaq pagesat përbëhen kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në vend si bankat komerciale dhe ndërmarrjet e huaja që operojnë në vend. Rritja e të hyrave nga investimet në periudhën raportuese kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga investimet e BQK-së dhe bankave komerciale në tregjet e jashtme, konkretisht investimet në letra me vlerë. Ndërkaq, rritja e pagesave në kuadër të të ardhurave nga investimet gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit kryesisht rezultoi nga rritja e fitimit të riinvestuar nga kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë.

Të ardhurat dytësore

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014, llogaria e të ardhurave dytësore kishte vlerën 532.0 milion euro, që paraqet një rënie vjetore prej 5.6 përqind (figura 39). Struktura e të ardhurave dytësore vazhdon të dominohet nga transferet e sektorëve tjerë, gjegjësisht transferet e korporatave financiare, korporatave jofinanciare, ekonomive familjare etj. (71 përqind e gjithsej të ardhurave dytësore) dhe nga transferet qeveritare (29 përqind e gjithsej të ardhurave dytësore). Zvogëlimi i bilancit të të ardhurave dytësore gjatë periudhës raportuese ishte pasojë e zvogëlimit të të hyrave në kuadër të transfereve të sektorëve tjerë dhe transfereve qeveritare.

Figura 39. Të ardhurat dytësore, në milionë euro




Në gjysmën e parë të vitit 2014, bilanci i transfereve qeveritare (trasferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut) u zvogëlua në 153.7 milionë euro, nga 176.9 milion euro sa ishte në gjysmën e parë të vitit paraprak, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të donacioneve. Gjithashtu, me zvogëlim të bilancit u karakterizuan edhe transferet e sektorëve tjerë, që në qershor 2014 kishin vlerën prej 378.3 milion euro (386.4 milion euro në qershor 2013).

Bilanci i transfereve të sektorit privat ishte më i ulët në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të transfereve të donatorëve për organizatat tjera joqeveritare. Remitencat, si kategori që dominojnë 67.2 përqind të gjithëj transfereve të sektorit privat u karakterizuan me rritje në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014. Deri në qershor të vitit 2014, remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 291.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqind (figura 40). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37 përkatësisht 23 përqind të gjithëj remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave dërgohet edhe nga Italia dhe Austria, që kanë pjesëmarrje prej 6 përkatësisht 4 përqind në gjithëj remitencat e pranuar në Kosovë. Sa i përket kanaleve të transferimit të remitencave në vend, rreth 22.3 përqind transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 42.2 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e dërgesave transferohen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale. Në anën tjetër, dërgesat e jorezidentëve në Kosovë drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 36.9 milionë euro deri në qershor 2014, një rënie prej 4.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

5.4.2 Llogaria financiare

Bilanci i llogarisë financiare në qershor 2014 ishte -86.2⁸ milionë euro krahasuar me bilancin prej -128.1 milionë euro në qershor 2013. Ky ndryshim i bilancit të llogarisë financiare i atribuohet jo vetëm zvogëlimit të aseteve por edhe nivelit më të ulët të detyrimeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Asetet u zvogëluan për 19.8 milionë euro ndërkohë që në qershor 2013 patën shënuar rritje prej 6.3 milionë euro, ndërsa detyrimet të cilat në gjysmën e parë të vitit 2013 patën shënuar rritje prej 134.3 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2014 u rritën për 66.4 milionë euro. Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte, ndërsa tek asetet kategoria kryesore vazhdon të jetë rritja e vazhdueshme e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së Kosovës (tabela 4).

Figura 40. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2015)

⁸ Bilanci negative i llogarisë financiare nënkupton më shumë investime të realizuar në Kosovë nga jorezidentët krahasuar me investimet e rezidentëve kosovarë jashtë Kosovës.

Tabela 4. Llogaria financiare, në milionë euro

Përshkrimi	Qer 2010	Qer 2011	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2014
LLOGARIA FINANCIARE	-152.3	-206.9	-100.2	-128.1	-86.2
<i>Asetet</i>	104.5	25.6	-14.2	6.3	-19.8
Investimet e huaja direkte (dalëse)	13.6	-5.0	8.1	8.0	1.5
Investimet portfolio	24.8	102.8	44.0	135.2	53.4
Investimet tjera	16.3	-104.8	-85.3	-145.2	-46.7
Asetet rezerve	49.9	32.7	19.1	8.3	-27.9
<i>Detyrimet</i>	256.8	232.5	86.0	134.3	66.4
Investimet e huaja direkte (hyrëse)	117.5	175.2	86.6	149.1	38.9
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet tjera	139.3	57.3	-0.6	-14.7	27.5

Burimi: BQK (2014)

Investimet e Huaja Direkte


Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë në periudhën janar-qershor 2014 shënuan vlerën prej 38.9 milionë euro që është për 110.1 milionë euro më ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 41). Gjithashtu, investimet e rezidentëve të Kosovës në vende tjera ishin dukshëm më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 1.5 milionë euro.

Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive.

Në kudër të IHD-ve, investimet në kapital aksionar shënuan vlerën prej 24.6 milionë euro (92.9 milionë euro deri në qershor 2013) ndërsa kreditë ndërmjet ndërmarrje ishin 14.3 milionë euro apo 41.9 milionë euro më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera më e ulët e IHD-ve në gjysmën e parë të vitit 2014 kryesisht i atribuohet edhe shitjes së aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë rezidentëve kosovar por edhe shpërndarjes së superdividendës⁹ nga disa prej kompanive të huaja.

Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në gjysmën e parë të vitit 2014 (15.3 milionë euro), pasuar nga Austria, Gjermania dhe Shqipëria të cilat investuan përafërsisht nga 13 milionë euro secila. Përderisa investimet nga Austria dhe Shqipëria shënuan rritje prej 49.5 përkatësisht 13.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, investimet nga Zvicra ishin më të ulëta për 25.6 përqind.

Figura 41. Investimet e huaja direkte, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

⁹ Me superdividendë nënkuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Deri në qershor 2014, investimet portfolio jashtë vendit arritën vlerën prej 53.4 milionë euro (135.2 milionë euro deri në qershor 2013). Pjesa më e madhe e investimeve portfolio përbëhen nga investimet e fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale. Në kuadër të investimeve portfolio, u shënuan një zhvendosje e investimeve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) nga investimet në letra me vlerë të borxhit drejt investimeve në aksione. Më konkretisht, investimet në letrave me vlerë të borxhit u zvogëluan për 16.6 milionë euro, ndërsa investimet në aksione shënuan rritje për 70.0 milionë euro.

Figura 42. Kreditë tregtare dhe importet, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)


Investimet tjera, të cilat përbëhen kryesisht prej depozitave dhe kredive, shënuan rënie prej 46.7 milionë euro. Ky zvogëlim i asetëve në kuadër të investimeve tjera i atribuohet rënies së depozitave, të cilat në gjysmën e parë të vitit 2014 shënuan vlerën prej -57.7 milionë euro. Në anën tjetër, kreditë bankare ndaj jo-rezidentëve shënuan rritje prej 7.5 milionë euro ndërkohë që edhe paradhëniet dhe llogaritë tjera të arkëtueshme shënuan rritje prej 3.4 milionë euro. Në kuadër të investimeve tjera, detyrimet shënuan rritje prej 27.5 milionë euro. Kjo rritje e detyrimeve ishte kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve në formë të kredive tregtare të cilat shënuan rritje prej 18.1 milionë euro, që mund të jetë e ndërlidhur edhe me rritjen e nivelit të importeve sepse, siç edhe është paraqitur në figurën 42, lëvizja e kredive tregtare është ngushtë e lidhur me lëvizjen e importeve. Përveç kredive tregtare edhe detyrimet në formë të depozitave të jo-rezidentëve shënuan rritje për 2.7 milionë euro.

Asetet rezervë, të cilat janë të investuara kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, deri në qershor 2014 janë zvogëluar për 27.9 milionë euro. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në Kosovë përdoret Euro si valutë zyrtare, e cila është e pranueshme në çdo transaksion ndërkombëtar, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera.

5.4.3 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI)¹⁰ neto në fund qershor 2014 ishte pozitiv dhe kishte vlerën prej 327.8 milionë euro (figura 43). Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rritës që nga vitit 2012, ku si përqindje e PBB-së nga

Figura 43. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro




Burimi: BQK (2015)

¹⁰ PNI paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të asetëve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korrigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Bilanci pozitiv i PNI-së nënkupton se shuma e mjeteve të investuara nga Kosova jashtë vendit është më e madhe se sa shuma e mjeteve të investuara nga shtetet tjera në Kosovë.

2.9 përqind sa ishte në qershor 2012 ka arritur në 5.9 përqind në qershor 2014. Në rritjen e bilancit të PNI-së ndikuan investimet tjera dhe investimet portfolio, bilanci i të cilave shënoi rritje vjetore prej 15.3 përkatësisht 12.5 përqind në qershor të vitit 2014. Në anën tjetër, bilanci i investimeve direkte vazhdoi të jetë negativ (më shumë IHD janë investuar në Kosovë nga jo-rezidentët krahasuar me IHD-të që kanë bërë rezidentët kosovar jashtë Kosovës) dhe shënoi rritje prej 5.7 përqind. Stoku i gjithsej IHD-ve të realizuara në Kosovë arriti vlerën prej 2.8 miliardë euro në qershor 2014 që është për 6.3 përqind më shumë se sa stoku i IHD-ve në qershor 2014. Edhe stoku i investimeve direkte të realizuara jashtë ekonomisë së Kosovës nga rezidentët kosovarë është rritur për 18.9 përqind dhe ka arritur vlerën prej 148.9 milionë euro.

Figura 44. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc pozitiv (1.4 miliardë përkatësisht 466.1 milionë euro në qershor të vitit 2014), ndërsa sektorët tjerë¹¹ dhe qeveria në vazhdimësi kanë pasur bilanc negativ (1.2 miliardë përkatësisht 318.9 milionë euro) (figura 44).


Gjithsej assetet në qershor 2014 arritën vlerën prej 4.1 miliardë euro (rritje vjetore prej 7.0 përqind). Rritjes së asetëve më së shumti i kanë kontribuar investimet portfolio të cilat shënuan rritje prej 12.5 përqind dhe investimet tjera të cilat shënuan rritje prej 10.1 përqind. Investimet portfolio, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e asetëve jashtë vendit (31.1 përqind), janë të investuara kryesisht në aksione në tregjet e kapitalit (58.7 përqind), ndërsa pjesa tjetër (41.3 përqind) në letra me vlerë të borxhit.

5.4.4 Borxhi i jashtëm

Në qershor 2014, Kosova kishte bilanc neto pozitiv të borxhit të jashtëm në vlerë prej 1.6 miliardë euro, që do të thotë se borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës (3.2 miliardë euro) është më i lartë se sa borxhi i ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit të jashtëm (1.6 miliardë euro).

Borxhi i jashtëm i Kosovës, i cili përfshinë borxhin e jashtëm privat dhe borxhin e jashtëm publik¹², në qershor 2014 arriti në 1.6 miliardë euro që është për 6.8 përqind më i lartë se sa në qershor 2013. Si përqindje e PBB-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 29.8 përqind (figura 45). Borxhi i jashtëm

Figura 45. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

¹¹ Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiar, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private, dhe individët.

¹² Në kuadër të borxhit publik përfshihet borxhi i qeverisë dhe bankës qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huat ndërmjet kompanive, sistemin bankar, dhe sektorët tjerë.

publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto, çka reflekton nivelin e ulët të borxhit të përgjithshëm publik në Kosovë krahasuar me vendet tjera të rajonit. Borxhi i jashtëm publik në fund të qershorit 2014 kishte vlerën prej 381.9 milionë euro apo 23.2 përqind e borxhit të jashtëm bruto.

Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huat ndërmjet kompanive (figura 46). Kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 697.8 milionë euro apo 42.4 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë (337.3 milionë euro ose 20.5 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm).


Borxhi i jashtëm i qeverisë në vlerë prej 318.9 milionë euro është kryesisht borxh i trashëguar që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 19.4 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm bruto. Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në qershor 2014 ishte 229.3 milionë euro ose 13.9 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat e jo-rezidentëve. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (62.9 milionë euro apo 3.8 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht stokut të alokimeve të Drejtave Speciale të Tërheqjes (angl. Special Drawing Rights: SDR) nga FMN-ja.

Borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës në qershor 2014 arriti në 3.2 miliardë euro. Këto mjete kryesisht janë fonde të investuara jashtë vendit si mjetet e privatizimit dhe të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, të cilat kryesisht janë të investuara në formë të depozitave me 76.2 përqind, pasuar nga mjetet e investuara në letra me vlerë të borxhit 18.1 përqind dhe kreditë të cilat kanë një pjesëmarrje prej 2.7 përqind.

5.5. Sektori fiskal


Deri në qershor 2014, sektori fiskal u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve buxhetore. Të hyrat e përgjithshme buxhetore¹³ shënuan rënie prej 0.3 përqind dhe arritën vlerën prej rreth 603.0 milionë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore¹⁴ arriti në rreth 625.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 2.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 22.0 milionë euro (7.6 milionë euro ishte deficitin në periudhën e njëjtë të vitit 2013) (figura 47). Borxhi i përgjithshëm i

Figura 46. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 47. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)


¹³ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi.

¹⁴ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, si dhe kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve buxhetore.

qeverisë në fund të qershorit 2014 ishte 554.4 milionë euro apo 9.9 përqind e PBB-së krahasuar me 9.1 përqind sa ishte në fund të vitit 2013.

Përkundër ngritjes së lehtë, Kosova ka nivel më të ulët të borxhit të përgjithshëm të qeverisë krahasuar me vendet e rajonit. Përderisa mesatarja e borxhit të përgjithshëm në vendet e EJJL-së gjatë vitit 2013 ishte 48.9 përqind e PBB-së, Kosova kishte nivelin më të ulët prej 9.1 përqind (figura 48). Për më tepër, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së në vendet e rajonit gjatë dy viteve të fundit është rritur për mesatarisht 5.1 pikë përqindje ndërsa në Kosovë rritja e borxhit publik ka qenë më e vogël, me vetëm 1.9 pikë përqindje. Përveç nivelit më të ulët të ngarkesës me borxhe publike, Kosova ka shkallën më të ulët të ngarkesës së ekonomisë me tatime, pasi që raporti i të hyrave buxhetore dhe PBB-së në vitin 2013 ishte 24.6 përqind krahasuar me mesataren e rajonit prej 34.8 përqind. Gjithashtu, raporti i shpenzimeve buxhetore prej 27.8 përqind të PBB-së është më i ulët krahasuar me mesataren e rajonit prej 38.9 përqind.

Figura 48. Treguesit kyresor fiskal të EJJL-së në vitin 2013 si përqindje e PBB-së




Burimi: FMN për vendet e rajonit, MF dhe kalkulimet e BQK-së për Kosovën (2015)

5.5.1 Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore në Kosovë përbëhen kryesisht nga të hyrat tatimore, të cilat në qershor 2014 kishin një pjesëmarrje prej rreth 85.2 përqind në gjithsej të hyrat buxhetore. Të hyrat vetanake të qeverisë qendrore dhe komunave përbëjnë 8.5 përqind të gjithsej të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur prej 6.3 përqind përbëhet nga të hyrat jo-tatimore (6.3 përqind).


Rënie e të hyrave buxhetore prej 0.3 përqind gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është kryesisht për shkak se gjatë kësaj periudhe nuk janë arkëtuar të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin realizuar 30.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda e realizuar në vitin 2013, atëherë të hyrat buxhetore deri në qershor 2014 shënuan rritje prej 4.9 përqind. Të hyrat tatimore shënuan rritje për 3.8 përqind dhe arritën vlerën prej 514.0 milionë euro. Në kuadër të të hyrave tatimore, të hyrat nga tatimet

Figura 49. Struktura e të hyrave buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

Figura 50. Të hyrat vendore neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro




Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

kufitare arritën vlerën prej 383.0 milionë euro që ishin për 5.8 përqind më të larta se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, përderisa të hyrat tatimore vendore shënuan nivelin prej 148.0 milionë euro që janë në nivel pothuajse të njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Të hyrat vetanake shënuan rritje prej 8.5 përqind dhe arritën vlerën prej 51.0 milionë euro. Të hyrat jo tatimore arritën vlerën prej 38.0 milionë euro që janë për 39.2 përqind më të ulëta se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar, krejsisht për shkak të dividendës (figura 49).

Në kuadër të tatimeve vendore, rritje shënuan tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi i bizneseve individuale me 12.5 përqind përkatësisht 8.1 përqind, ndërsa TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat e korporatave shënuan rënie për 12.6 përkatësisht 8.3 përqind (figura 50).

Performanca pozitive e tatimeve kufitare është rezultat i rritjes së të hyrave nga të gjitha llojet e tatimeve që, përveç efikasitetit të doganës në luftimin e ekonomisë joformale, reflekton edhe rritjen e nivelit të importeve. Në kuadër të të hyrave kufitare, kategoria kryesore mbetet TVSH-ja, me një pjesëmarrje prej 49.3 përqind të gjithsej të hyrave kufitare (figura 51). Deri në qershor 2014, të hyrat nga TVSH-ja e mbledhur në kufi shënuan rritje prej 3.3 përqind dhe arritën vlerën neto prej 187.9 milionë euro. Të hyrat kufitare nga akciza, që kanë një pjesëmarrje prej 35.3 përqind në gjithsej të hyrat kufitare, shënuan rritje prej 7.9 përqind dhe arritën vlerën neto prej 134.7 milionë euro. Të hyrat nga tatimi doganor, që përfaqësojnë 14.8 përqind të gjithsej të hyrave kufitare, shënuan rritje prej 14.8 përqind dhe arritën vlerën neto prej 56.4 milionë euro.


Figura 51. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro



5.5.2 Shpenzimet buxhetore

Deri në qershor 2014, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 625.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.1 përqind. Shpenzimet rrjedhëse, të cilat përbëhen nga pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, dhe subvencionet e transferet, shënuan vlerën 488.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 16.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje vjetore prej 34.0 përqind, duke arritur në 233.0 milionë euro. Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet qeveritare për subvencione e transferet si dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime. Shpenzimet për subvencione e transfere shënuan rritje prej 4.2 përqind dhe arritën vlerën prej 164.0 milionë euro ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime arritën vlerën prej 91.0 milionë euro apo 2.8 përqind më shumë se sa shpenzimet e shënuara për këtë kategori në periudhën e njëjtë të vitit 2013.

Figura 52. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Shpenzimet qeveritare për investime kapitale deri në qershor 2014 arritën vlerën prej 137.0 milionë euro që është për rreth 30 përqind më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 52). Zvogëlimi i investimeve kapitale gjatë kësaj periudhe kryesisht i adresohet përfundimit të projektit të autostradës R-7, e cila në gjysmën e parë të vitit 2013 ka qenë në implementim e sipër

5.6. Sistemi Financiar

Stabiliteti i sistemit financiar paraqet një shtyllë të rëndësishme për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ndërlidhja e stabilitetit të sektorit bankar me aktivitetin ekonomik vazhdon të potencohet në mënyrë të vazhdueshme nga politikë-bërësit në nivel rajonal dhe global, që aktualisht po bazojnë hartimin dhe ndryshimin e vendimeve të politikave monetare mbi bazën e projeksioneve makroekonomike. Rritja e vazhdueshme e aktivitetit që karakterizoi të gjitha segmentet përbërëse të sistemit financiar në Kosovë dhe menaxhimi i mirë i rreziqeve bankare ka rezultuar në performancë të mirë dhe pozicion të mirë likuiditetit, cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe nivel të lartë të kapitalizimit.

Në gjysmën e parë të vitit 2014, gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.3 miliard euro, që përkon me një rritje vjetore prej 12.2 përqind. Trendi i përforcuar i rritjes së aseteve të sistemit financiar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 kryesisht i atribuohet rritjes së aseteve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale.


Dinamika e aktivitetit kreditues të sektorit bankar në vend u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014. Gjithsej kreditë bankare arritën vlerën 1.89 miliard euro, që paraqet një vjetore prej 3.5 përqind në qershor 2014 (2.8 përqind në qershor 2013) (figura 53). Përkundër rritjes së vazhdueshme të kreditimit bankar, raporti i gjithsej kredive ndaj PBB-së vazhdon të jetë relativisht i ulët me normë prej rreth 35 përqind, duke sugjeruar hapësirë të mëtejme për rritje të aktivitetit kreditor.

Përshpejtimi i rritjes së kredive bankare gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 kryesisht i atribuohet ofertës më të lehtësuar kredituese të bankave për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.

Kërkesa për kredi ishte përgjithësisht më e ulët nga ndërmarrjet, përderisa ekonomitë familjare u karakterizuan me zvogëlim të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive dhe rritje të kërkesës për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera.


Sektorët ekonomik që siguruan mbështetjen më të madhe financiare nga sektori bankar në vitin 2014 ishin prodhimi, energjetika, tregtia dhe shërbimet tjera (hoteliere dhe restorante,

Figura 53. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 54. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


patundshmëri dhe qera, dhe shërbime tjera). Përderisa në vitet e fundit portfolio kreditore për sektorin e bujqësisë është rritur në vazhdimësi, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, mbështetja bankare për këtë sektor është zvogëluar dukshëm (figura 54). Zvogëlimi i mbështetjes financiare për sektorin e bujqësisë në gjashtëmuorin e parë 2014 mund ti atribuohet deri në një masë përfundimit të pjesës më të madhe të projektit të USAID-it për garantimin e kredive për sektorin e bujqësisë, gjë që rikonfirmon hezitimin e bankave për zgjerim të kreditimit për sektorin e bujqësisë. Andaj, garantimi i kredive përmes skemave të ngjashme mund të ndikojë në zvogëlimin e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut që rrjedhë nga kreditimi i këtij sektori, si dhe në zvogëlimin e kostos së financimit për këtë sektor. Normat e interesit në kreditë për bujqësi vazhdojnë të jenë mjaft të larta në krahasim me kreditë për sektorët tjerë, gjë që dekurajon kërkesën për kredi nga ky sektor. Përveç bujqësisë, mbështetje më të ulët bankare krahasuar me vitin paraprak siguruan edhe sektori i minierave dhe sektori i ndërtimitarisë, që mund të reflektojë deri në një masë ngadalësim të aktivitetit në këta dy sektor të ekonomisë.

Në gjysmën e parë të vitit 2014, oferta më të lehtësuar kredituese e bankave komerciale në vend është realizuar kryesisht përmes uljes së normave mesatare të interesit për kreditë. Norma e interesit në kredi u zvogëluar në 10.6 përqind në qershor 2014 (12.0 përqind në qershor të vitit 2013). Megjithatë, me intensitet më të lartë të rënies u karakterizuan normat mesatare të interesit në depozita, të cilat në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 zbritën në 0.6 përqind (3.5 përqind) (figura 55). Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita shënoj rritje në 10.0 pp nga 8.5 pp në qershor 2013.

Burim kryesor i financimit për sektorin bankar vazhdojnë të mbeten depozitat, që në qershor të vitit 2014 shënuan rritje vjetore prej 10 përqind. Depozitat e sektorit bankar në vend arritën vlerën prej 2.42 miliard euro në qershor 2014 dhe përfaqësuan 79 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit. Sektori bankar në vend është karakterizuar me një rritje të përsheptuar të depozitave në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014, përkundër rënies së theksuar të normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar një stabilitet të lartë të depozitave në sektorin bankar të Kosovës.


Deri në qershor të vitit 2014, performanca e sektorit bankar u përmirësua dukshëm, duke shënuar fitim neto në vlerë prej 26.9 milion, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak paraqet një rritje vjetore prej 77.1 përqind. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë, të shprehur me menaxhim të mirë të rreziqeve bankare. Në qershor

Figura 55. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Figura 56. Treguesit e profitabilitetit



*Të dhënat për qershor 2014 janë të anualizuara
Burimi: BQK (2016)

2014, treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, gjë që ndikoi në përmirësimin e pozitës së likuiditetit të sektorit bankar (figura 56). Gjithashtu, sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit, duke tejkaluar kërkesat minimale rregullative. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor në qershor 2014 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak mund të vlerësohet të jetë rritur, ku raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive arriti në 8.2 përqind (7.8 përqind në qershor 2013) (figura 57). Sidoqoftë, vlenë të theksohet se që nga muaji shkurt i vitit 2014, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive është karakterizuar me rënie. Kreditë joperformuese vazhdojnë të kenë shkallë të kënaqshme të mbulueshmërisë nga provizionet për humbje nga kreditë (116.4 përqind në qershor 2014).

Figura 57. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2015)

6. Parashikimet makroekonomike për vitin 2015


6.1. Produkti i brendshëm bruto

Parashikimet makroekonomike të BQK-së sugjerojnë se në vitin 2015 ekonomia e Kosovës do të rritet me ritëm më të shpejtë në krahasim me vitin 2014. Norma reale e rritjes së PBB-së në vitin 2015 pritet të jetë 3.9 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme (kryesisht investimet), ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e PBB-së (figura 58).

